



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 168, Datë 28.06.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 13 dhe nenit 14, pika 2, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 935/4 prot., datë 23.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 20.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 70/13 prot., datë 22.04.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.05.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Me shkresën nr. 469/1 prot., datë 27.04.2022, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin dhe informacionin shtesë me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/3 prot., datë 11.05.2022, dhe nr. 495/6 prot., datë 24.05.2022.
- Në kuptim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 135, datë 06.06.2022, shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k., duhej të depozitonte në ERE, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë siç përcaktuar në nenin 9, pika 2, gërma “d” të rregullores së sipërcituar.

- Brenda afatit të përcaktuar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 470/2 prot., datë 20.06.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike", shoqëria ka plotësuar dokumentacionin si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat "a", "b" dhe "c".
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat "a", "b", "c" dhe "e".
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat "a", "b", "c" dhe "d".
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, gërmat "a", "b" dhe "c".
- ***Për sa i përket kërkesave të nenit 9, pika 2, gërma "d", të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor.***

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë "Salillari Energy Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k. të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI